



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:099156

Datë: 17.03.2021

Numri i dokumentit: 01606672

C.nr. 818/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Raif Fazliu, në çështjen juridike të paditësit N.N. nga fshati Smirë, Komuna e Vitisë, të cilin me autorizim, e përfaqëson Visar Musa, avokat në Ferizaj, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve - BKS me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar Leonora Rrecaj, juriste nga Prishtina, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, pas mbajtjes të shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesve të palëve më datë 04.03.2021, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit N.N. nga Smira e Vitisë, **DETYROHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditësit t`ia kompensoj shpërblimin për vdekjen e vëllait të tij N.N. i moshës 64 vjeçare, në aksidentin e komunikacionit të datës 23.05.2013, në Partesh, si këmbësor, i shkaktuar nga automjeti dhe personi i pa njohur – NN, andaj e paditura, paditësin duhet ta shpërblej në emër të:

Dëmin jo material duhet t`i kompensoj si në vijim:

- N.N., vëllai i të ndjerit N.N., për dhimbje shpirtërore shpërblehet me 7,000 euro.

Dëmit material:

- Për shpenzimet e varrimit shumën prej 1,400 euro dhe

- Për shpenzimet për ngritjen e përmendores, shumën prej 800 euro.

Gjithsej dëmi material 2,200 € (dymijë e dyqind euro).

Gjithsej dëmi jo material dhe material është 9,200 euro (nëntëmijë e dyqind euro).

Të gjitha me kamatë vjetore prej 8 %, për dëmin material prej datës së ushtrimit të padisë në gjykatë me 18.11.2013, kurse për dëmin jo material nga data e vendosjes me aktgjykimin e parë C.nr.385/13, me datë 06.09.2016, e deri në pagesën përfundimtare.

- Obligohet e paditura BKS që t`ia kompensoj paditësit N.N. shpenzimet e procedurës kontestmore dhe atë 104 €uro për përpilimin e padisë, 50 euro për pagimin e taksës në padi dhe 810 €, për përfaqësim të avokatit në gjashtë seanca gjyqësore, apo gjithsej 964 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi N.N. nga fshati Smirë, Komuna e Vitisë, përmes përfaqësuesit të tij, me padinë e dorëzuar me datë 18.11.2013, ka deklaruar se me datë 23.05.2013, rreth orës 08:00, ne rrugën publike në fshatin Partesh, në aksident komunikacioni nga vetura dhe personi që ka drejtuar veturën të panjohur (të panjohur kanë mbetur edhe tani), kishte humbur jetën N.N., me vendbanim në fshatin Smirë, të Komunës së Vitisë.

Meqenëse ne këtë aksident kishte humbur jetën një person, i cili ishte vëlla i paditësit N.N., duke u bazuar ne nenin 177 dhe 184 te LMD-së dhe nenit 26, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, duhet ta kompensoje paditësin për shkak të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, për humbjen e vëllait.

Përmes padisë kishte kërkuar shumën prej 36,000 euro për gjithë paditësit duke përfshirë edhe pesë paditësit tjerë si N.N., djali i paditësit, N.N., reja e paditësit, N.N., N.N., nipat dhe N.N. mbesa e paditësit.

Të paditurës iu ishte dërguar padia në përgjigje, ku edhe e paditura kishte konsideruar se paditësi nuk e kishte paraqitur me kohë kërkesën për dëmshpërblim siç e parasheh Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia. Andaj kishte propozuar qe padia e paditësit te hedhet poshtë si e pa bazuar në mungesë të provave.

Në seancën përgatitore të mbajtur me datë 22.07.2016, përfaqësuesi i paditësit kishte mbetur tërësisht pranë padisë dhe thënieve ne padi duke i propozuar gjykatës që në pajim me dispozitat e LMD-së, të nxjerrë aktgjykim gjykata dhe ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësve.

Përfaqësuesi i të paditurës kishte deklaruar se paditësi N.N. me të ndjerin N.N. nuk janë vëllezër, pasi që ne disa dokumente të regjistrimit civil mbiemrat e tyre nuk përputhen, por gjithashtu kishte kërkuar të njoftohet nga prokuroria e shtetit se a mos është zbuluar se kush e kishte goditur të ndjerin N.N., andaj edhe nuk ishte deklaruar lidhur me bazën juridike.

Por përfaqësuesi i paditësit kishte eliminuar këto dilema te pala e paditur duke sjellë provat nga Prokuroria e Shtetit ne Gjilan, se deri me tani nuk është gjetur dhe zbuluar kush ka shkaktuar aksidentin, si dhe dëshminë se paditësi me te ndjerin ishin vëllezër.

Me datë 29.06.2016, paditësi kishte precizuar kërkesëpadinë, me parashtrësën me shkrim duke kërkuar qe paditës te trajtohet vetëm N.N., ndërsa kishte hequr dore nga te tjerët, te cilët me paditësin ishin djalë, re, nipa dhe mbesë e paditësit.

Ne seancën kryesore të datës 12.08.2016, palët kishin mbetur pranë qëndrimeve si nga e seanca paraprake, kurse te paditurën e kishte përfaqësuar Faik Sylejmani, i cili kishte shkuar edhe me larg duke theksuar se kontribut mbanë edhe i ndjeri N.N., i cili ne momentin e aksidentit kishte lëvizur ne anën e djathtë të shiritit të rrugës.

Gjykata përmes Aktgjykimit C.nr.385/2013, datë 06.09.2016, kishte vendosur duke ia miratuar kërkesën e paditësit pjesërisht (sikur në dispozitivin e këtij aktgjykimi), por i pa kënaqur me vendimin, e paditura BKS, kishte ushtruar ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit e kishte miratuar si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa çështjen e kishte kthyer në rigjykim dhe vendosje.

Paditësi kishte angazhuar avokat Visar Musa, i cili në seancën përgatitore me datë 19.01.2021, i cili kishte mbetur pranë padisë e kërkesës së saj, ndërsa bazuar në vërejtjet e vendimit të Gjykatës së Apelit Ac.4030/16, i datës 12.09.2020, ky përfaqësues kishte dorëzuar provën materiale – vërtetimin nr.7657/20, datë 09.12.2020, i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile (ZGJC) në Viti, i nxjerrë nga deklarata nën betim nr.5089/20, e datës 09.12.2020, e dhënë para noterit Naser Pajaziti me seli në Viti, nga deklarata dhënësit N.N. dhe Kushtrim Hasani nga Smira e Vitisë. Deklarata sqaronte rrethanat se paditësi N.N. me të ndjerin N.N. ishin vëllezër dhe të njëjtit kishin jetuar bashkë në të njëjtën bashkësi familjare dhe në një shtëpi në fshatin Smirë. Kishte propozuar që në cilësi të dëshmitarëve nën rrethanat e njëjta të dëgjohen këta dy persona, sikur edhe Ibush Sylejmani dhe Muhamet Osmani.

Edhe përfaqësuesja e të paditurës nuk e kishte kundërshtuar propozimin për dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar.

Gjykata kishte vendosur t'i dëgjoj tre dëshmitarët e parë, por jo edhe Muhamet Osmani, duke konsideruar se tre dëshmitarë janë të mjaftueshëm.

Dëshmitari N.N., mes tjerash ka deklaruar se Hajrushu dhe Hyseni ishin vëllezër nga prindërit e njëjtë, ndërsa sa i përket çështjes se a kishin jetuar bashkë këta dy persona ai ishte kontradiktor,

duke deklaruar se i ndjeri e ka pasur një shtëpi të veten por të pa rregulluar dhe vetëm njëdhomëshe, ndërsa vitin e fundit para se të vdiste ky dëshmitar ka deklaruar se i ndjeri ka jetuar në shtëpinë e vetë, por për ushqimin ishte kujdesur paditësi N.N..

Ndërsa dëshmitari Kushtrim Hasani, doli të jetë tërësisht i dështuar dhe i pa informuar për çështjen konkrete, për çka ishte ftuar.

Pas dëgjimit të këtyre dëshmitarëve, të cilat dëshmi ishin të mangëta për rastin konkret, gjykata vendosi që zyrtarisht të kërkoj sigurimin e provës nga KEDS-i, për të vërtetuar se i ndjeri N.N., por edhe paditësi N.N., a ishin të regjistruar si konsumatorë të energjisë elektrike apo jo, ndërsa nga sektori i tatimit në pronë kishim kërkuar të na i siguroj dëshminë se i ndjeri dhe paditësi a ishin të ngarkuar me obligimin për pagesën e tatimit në pronë, thjesht a posedonin shtëpi të veten këta dy persona.

Nga informata e sektorit të tatimit në pronë veç tjerash thuhet se Hysen Halit Haliti (i ndjeri), nuk posedon barrë të tatimit dhe nuk është i evidentuar në evidencat e këtij sektori, kurse Hajrush Halit Hyseni (paditësi), nuk posedon barrë tatimore, mirëpo ka poseduar në pronësi një shtëpi të vjetër, e cila tash ajo është rrënuar.

Kurse në informatën e KEDS-it, njoftohemi se këta dy persona (i ndjeri dhe paditësi), ishin të regjistruar si konsumatorë nga fillimi, pasi që shifrat e tyre janë të vjetra.

Në njehsorin elektrik të ndjerit vërehet se ai edhe tani ka borxhin e pa shlyer në vlerë prej 1,132.12 €, por që dikush paguan obligimet, fakt që vërtetohet përmes transaksioneve të konsumatorit me nr.30338, ku vërehet se dikush ka kryer pagesat në shumë prej 50 € gjatë muajit janar 2021 dhe 45 € shumën tjetër. Po ashtu vërehet se në emër të ndjerit ishte paguar borxhi në shumë prej 2,489.20 €, në muajin dhjetor 2020, edhe pse i ndjeri nuk ka mund të harxhoj energjinë elektrike. Me këto të dhëna dikush tjetër e shfrytëzon njehsorin elektrik të të ndjerit.

Në seancën e fundit të shqyrtimit kryesor me 04.03.2021, përfaqësuesit e palëve kishin mbetur pranë pretendimeve si në seancat paraprake, ndërsa gjykata kishte dëgjuar dëshmitarin Ibush Sylejmani, në rrethanat se a ishin apo jo vëllezër paditësi N.N. me të ndjerin N.N. dhe se a kishte ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme mes tyre, deri në aksidentimin e të ndjerit.

Mes deklarimeve të shumta të dëshmitarit Ibush Sylejmani, gjykata veçon: se Hajrush dhe Hyseni ishin vëllezër nga prindërit e njëjtë, ku vëllezër me këta dy ishin edhe Muhabiu dhe Sameti, ndërsa i ndjeri Hysen edhe pse kishte qenë i martuar, ai fëmijë nuk kishte lindur fare, ai kishte pasur një shtëpi të veten, në të cilën kishte jetuar me bashkëshorten e vetë deri sa nuk ishin ndarë faktikisht mes vete, ndërsa pasi ishin ndarë me bashkëshorten, diku dy vite më vonë ai ishte sëmurë psiçikisht, andaj ishte detyruar të jeton në shtëpinë e vëllait të tij N.N.t, i cili nuk e kishte ndarë nga familja e tij e ngushtë.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, në këtë çështje juridike, duke administruar provat, si Raportin e aksidentit me nr. 2013-CR-146, i datës 23.05.2013, si dhe skicimi i vendit të ngjarjes me numër dhe datë të njëjtë, lexohet certifikata e vdekjes me nr. rasti MA13-127, ne emër të N.N., e datës 24.05.2013, e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë-Departamenti i Mjekësisë Ligjore, certifikata e vdekjes me nr. serik V 00096078, e datës 20.07.2013, për të ndjerin N.N. e lëshuar nga ZGJC ne Partesh, ekstrakti i lindjes me nr.E 00763775, i datës 26.07.2013, në emër te paditësit Hajrush Hysen, deklarata e bashkësisë familjare me nr. F00451186, e datës 27.07.2013 e lëshuar nga ZGJC në Viti, përgjigja me nr.422/2013, datë 11.04.2016, e dhënë nga Prokuroria Themelore ne Gjilan, Deklarata me nr.LRP 3385/2016, datë 22.07.2016, e vërtetuar tek noteri Agim Sylejmani në Viti, kuponi me nr.0458375, i datës 30.05.2013, i lëshuar nga gjelltorja “Zabeli” në Viti, i cili mbanë shumë prej 2,500 euro dhe copëz letër me vlerë prej 2,500 euro, e nënshkruar dhe vulosur nga NPTSH “Dyli Mermer” në Viti, Informata e dhënë nga sektori i tatimit në pronë, pranë komunës së Vitisë dhe transaksionet e konsumatorit në emër të N.N. dhe N.N., të datës

03.03.2021, të lëshuara nga KEDS-i. Pala e kishte kundërshtuar provën e fundit të lëshuar nga KEDs, ndërsa e paditura pa vërejtje.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit, N.N. av. Visar Musa kishte deklaruar: mbi bazën e provave të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor qartë rezultoi se kërkesa e paditësit është e arsyeshme dhe e bazuar plotësisht në dispozitat e nenit 184, të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore. E paditura në procedurë administrative me datë 23.10.2013, me ofertën e saj i kishte ofruar shumën prej 3,200 euro. Tani kërkesa e paditësit ishte aq sa gjykata kishte vendosur me aktgjykimin C.nr.385/2013, datë 06.09.2016, me kamatë ligjore prej 8%, prej momentit të ngritjes së padisë në gjykatë.

Kishte kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar si, 104 euro për përpilimin e padisë, për taksa gjyqësore 50 euro dhe për gjashtë përfaqësime të avokatit shumen prej 810 euro, apo gjithsej 964 euro.

Kurse përfaqësuesja e të paditurës BKS, në fjalën përfundimtare, e kishte kundërshtuar padinë dhe kërkesën e paditësit, me arsyetimin se gjitha provat në lëndë janë në kundërshtim njëra me tjetren, duke e apostrofuuar deklaratën e dhënë nga dëshmitari N.N., duke propozuar që për shpenzimet e procedurës gjykata të vendos në bazë të suksesit.

Gjykata provat e administruara i ka çmuar dhe vlerësuar veç e veç dhe si tërësi, bazuar në nenin 8, të LPK-së, duke konstatuar se:

- Me leximin e Raportit të aksidentit me nr. 2013-CR-146, i datës 23.05.2013, si dhe skicimi i vendit të ngjarjes me numër dhe datë të njëjtë, gjykata vërteton se me datë 23.05.2013, në rrugën publike Gjilan-Ferizaj, në dalje të fshatit Partesh, N.N. nga fshati Smirë i komunës së Vitisë, duke ecur si këmbësor, nga pasojat e goditjes së automjetit dhe drejtuesit të automjetit NN, apo të panjohur, kishte vdekur në vend të ngjarjes, në momentin e shkakut të aksidentit.
- Me leximin e certifikatës së vdekjes me nr. rasti MA13-127, në emër të N.N., e hartuar me datë 24.05.2013, kurse lëshuar me datë 24.07.2013, e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë-Departamenti i Mjekësisë Ligjore, gjykata vërteton se N.N., i lindur me 10.06.1949, kishte vdekur me 23.05.2013, në fshatin Partesh/Gjilan, në aksident komunikacioni, i lindur nga babai Halit, e nëna Vahide Hyseni. Këto fakte i vërteton edhe certifikata e vdekjes me nr. serik V 00096078, e datës 20.07.2013, për të ndjerin N.N. e lëshuar nga ZGJC në Partesh.
- Me leximin e ekstraktit të lindjes me nr.E 00763775, e datës 26.07.2013, në emër të paditësit Hajrush Hysen gjykata vërteton se ky paditës, është vëlla biologjik me të ndjerin N.N..
- Me leximin e deklaratës së bashkësisë familjare me numër F 00451186, e datës 27.07.2013 e lëshuar nga ZGJC në Viti, gjykata konstaton dhe vërteton se mes paditësit N.N. me të vdekurin N.N. ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme, ashtu siç e parashihet nën 184, pika 2, e LMD-së, por këtë fakt e vërteton edhe Deklarata me nr.LRP 3385/2016, datës 22.07.2016, e vërtetuar tek noteri Agim Sylejmani në Viti.
- Me leximin e përgjegjës me nr.422/2013, datë 11.04.2016, e dhënë nga Prokuroria Themelore në Gjilan, gjykata vërteton se shkaktori i aksidentit ende nuk ishte zbuluar.
- Me leximin e kuponit me nr.0458375, i datës 30.05.2013, i lëshuar nga gjellëtorja “Zabeli” në Viti, i cili mbanë shumën prej 2,500 euro dhe letrës me vlerë prej 2,500 euro, e nënshkruar dhe vulosur nga NPTSH “Dyli Mermer” në Viti, gjykata vërteton se për shpenzimet e varrimit janë krijuar shpenzime, sikur edhe për ngritjen e përmendores. Duhet theksuar se këto “prova” janë vlerësuar të rritura dhe jo zyrtare, pasi që iu mungon kuponi fiskal.
- Me leximin e Informatës së dhënë nga sektori i tatimit në pronë, pranë komunës së Vitisë, gjykata mëson se Hysen Halit Haliti (i ndjeri), nuk posedonte barrë të tatimit dhe nuk ishte i evidentuar në evidencat e këtij sektori, kurse N.N. (paditësi), edhe pse nuk posedon barrë tatimore, ai ka poseduar në pronësi një shtëpi të vjetër, e cila tanimë është rrënuar.

- Me leximin e transaksioneve të konsumatorit në emër të N.N. dhe N.N., të datës 03.03.2021, të lëshuara nga KEDS-i, gjykata mëson se të dy këta persona kishin qenë dhe janë të regjistruar në listë si konsumatorë të energjisë elektrike, ndërsa kjo vërtetohet nga transaksionet e këtyre konsumatorëve, ku vërtetohet se edhe në muajin shkurt 2021, N.N. ka shpenzuar energji në vlerë prej 38.32 €, ndërsa N.N. ka shpenzuar energji në vlerën prej 39.47 euro. Për çudi për energjinë e shpenzuar, vërehet se pagesa të rregullta kryhen edhe në emër të ndjerit N.N., andaj kjo na jep me kuptuar se realisht njëtori elektrik vetëm formalisht ka mbetur apo edhe ka qenë i regjistruar në emër të ndjerit.

Si tërsi këto prova vërtetojnë se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datë 23.05.2013, ku nga ky aksident në vendngjarje ka humbur jetën N.N., jo kontestuese për palët.

Gjykata në veçanti ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit Ibush Sylejmani, i dëgjuar në seancën kryesore, i cili kishte sqaruar dilemat e deritashme se paditësi N.N. dhe i ndjeri N.N. vërtetë ishin vëllezër nga prindërit e njëjtë, e sidomos dilemën edhe të gjykatës se ndërmjet tyre vërtetë kishte ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme, deri në aksidentin e të ndjerit.

Deklarata e këtij dëshmitari ishte kyçe bashkë me provën materiale, respektivisht deklaratën e bashkësisë familjare me numër F 00451186, e datës 27.07.2013 e lëshuar nga ZGJC në Viti, andaj gjykata konstaton dhe vërteton se mes paditësit N.N. me të vdekurin N.N. ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme, ashtu siç e parasheh neni 184, pika 2, e LMD-së. Gjykata në tërësi ia ka falur besimin dëshmisë së këtij dëshmitari, pasi që nga gjithë dëshmitarët e dëgjuar vetëm Ibush Sylejmani ishte nga fshati Smirë, prej nga ishin edhe Hajrushu dhe i ndjeri N.N..

Natyrisht se gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palëve, ku pretendimet e palës paditëse ishin të provuara edhe me shkresa materiale, sa për t'i eliminuar dilemat e pa vërtetuara me rastin e vendosjes së lëndës herën e parë, andaj edhe vërejtjet dhe udhëzimet e Gjykatës së Apelit të paraqitura në aktvendimin e saj Ac.nr.4030/16, konsiderojmë se pala paditëse i ka plotësuar duke i argumentuar me prova.

Edhe gjykata rrethanat kontestuese i ka sqaruar me nxjerrjen e provave nga organet kompetente shtetërore, si ajo e sektorit të tatimit në pronë dhe KEDS-i, të cilat e argumentojnë dilemën se paditësi ka bashkëjetuar në vazhdimësi me vëllain e tij, të ndjerin N.N..

Gjykata pasi i vlerësoj provat një nga një, konstaton se është dashur te vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që ndërmjet palëve ndergjyqjese nuk ka qenë kontestues fakti se i ndjeri N.N. ka vdekur ne aksidentin e komunikacionit të datës 23.05.2013 në cilësi të këmbësorit, nga vetura dhe ngasësi i saj i panjohur.

Po ashtu, tanimë nuk është kontestues edhe fakti se paditësi N.N. me të ndjerin N.N., kishin jetuar në bashkësi të vazhdueshme familjare.

Me qenë se është vërtetuar se paditësi dhe i ndjeri kishin jetuar bashkë në të njëjtën bashkësi, për shkak të vdekjes së vëllait, paditësi kishte përjetur dhimbje të thella shpirtërore. Këto dhimbje janë të pa llogaritshme dhe të pa kompensueshme, për çka paditësi nuk mund të kompensohet me kurrfar shpërblime në të holla, por gjykata vlerëson se shpërblimi adekuad në të holla, megjithatë mund t'ia zbusë dhimbjen e paditësit dhe se plotësimi i nevojave jetësore i paditësit me shpërblim adekuad, do të jetë me ndikim në vendosjen e baraspeshës psikike dhe emocionale të tij, prandaj për këto arsye por edhe duke u bazuar ne dispozitat ligjore materiale, gjykata ia njuh paditësit të drejtën në shpërblimin e dëmit jo material, përshkak të dhimbjeve të pëjetuara shpirtërore.

Lartësinë e shpërblimit për dhimbje shpirtërore gjykata e ka caktuar duke marr për bazë të gjitha rrethanat në ndikim intensitetin e këtyre dhimbjeve, siç janë afërsia gjinore me të ndjerin e të tjera rrethana.

Po ashtu gjykata ka vendosur edhe për kompesimin për dëmin material siç janë shpenzimet e varrimit, të cilat bëhen si rezultat i organizimit të cermonive te varrimit sipas zakoneve vendore. Gjykata paditësit i ka caktuar kompesimin për shpenzimet e varrimit ne

shumë prej 1,400 euro me vlersimin se këto shpenzime i përgjigjen lartësisë së shpenzimeve normale për cermoni të vorrimit, duke e llogaritur shujtën ditore për 100 persona, ndërsa është llogaritur për 5 ditë nga rreth 3 euro.

Gjykata paditësit i ka nda shumën në lartësi prej 800 euro për ngritjen e përmendorës për të ndjerin, duke u bazuar në rrethanat dhe kushtet të cilat sot kushton ngritja e një përmendore të tillë.

Gjykata kamatën prej 8% për gjitha kategoritë e shpërblimeve e ka caktuar duke u bazuar në nenin 382, të LMD-së, ashtu siç ka vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Natyrisht se gjykata për lartësinë e shpërblimit të dëmit jo material ka vendosur, bazuar në rëndësinë e cenimit të së mires (humbjes së vëllaut) dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës gjykata i ka bazuar në nenin 452, pika 1 e LPK-së.

Gjykata vendimin për aprovimin e kërkesëpadisë e bazoi në dispozitën ligjore të nenit 183 dhe 184.2, të LMD-së.

Nga të cekurat më lartë dhe bindjes së lirë të gjykatës, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI

C.nr.818/2020

Më:04.03.2021

Gj y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, 15 ditë pas ditës së pranimit të njëjtit aktgjykim. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.